

**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 29.5.2012**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE**  
**SHTESË NGA BANKA RAIFFEISEN SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Raiffeisen sh.a., të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

a) Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Raiffeisen sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**